



KRYQI I KUQ I KOSOVËS  
RED CROSS OF KOSOVA

# STATUTI

Nëntor, 2019



---

## PËRMBAJTJA

---

### KAPITULLI I

IDENTITETI I SHOQATËS KOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....

5

HYRJE .....

5

I. PARIMET THEMELORE .....

5

HUMANITETI .....

5

PAANËSIA.....

5

NEUTRALITETI .....

5

PAVARËSIA .....

6

SHËRBIMI VULLNETAR.....

6

UNITETI .....

6

UNIVERSALITETI .....

6

II. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME .....

6

**NENI 1** MISIONI I KRYQIT TË KUQ TË KOSOVËS .....

6

**NENI 2** DETYRAT .....

7

**NENI 3** STATUSI LIGJOR KOMBËTAR .....

8

**NENI 4** MARRËDHËNIET ME KOMPONENTËT TJERË TË LËVIZJES .....

9

**NENI 5** MARRËVESHJET .....

9

**NENI 6** EMBLEMA E KRYQIT TË KUQ TË KOSOVËS.....

9

### KAPITULLI II

ANËTARËT.....

10

**NENI 7** ANËTARËSIMI .....

10

**NENI 8** OBLIGIMET E ANËTARËVE.....

10

**NENI 9** TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE AKTIVË:.....

11

**NENI 10** HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT AKTIV.....

10

### KAPITULLI III

VULLNETARËT .....

12

**NENI 11** VULLNETARËT .....

12

### KAPITULLI IV

UDHËHËQJA (QEVERISJA DHE MENAXHIMI) .....

13

**NENI 12** KUVENDI I PËRGJITHSHËM .....

13

**NENI 13**.....

13

<b>NENI 14</b> KOMPETENCAT E KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM .....	13
<b>NENI 15</b> SEANCA E KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM .....	14
<b>NENI 16</b> PROCEDURA E KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM .....	14
<b>NENI 17</b> KRYESIA QENDRORE.....	14
<b>NENI 18</b> KOMPETENCAT E KRYESISË QENDRORE .....	15
<b>NENI 19</b> MBLEDHJET E KRYESISË QENDRORE.....	16
<b>NENI 20</b> PROCEDURAT E KRYESISË QENDRORE .....	16
<b>NENI 21</b> KRYETARI.....	17
<b>NENI 22</b> ZËVENDËSKRYETARI .....	17
<b>NENI 23</b> KOMISIONI PËR FINANCA .....	18
<b>NENI 24</b> KOMPETENCAT E KOMISIONIT PËR FINANCA.....	18
<b>NENI 25</b> SEKRETARI I PËRGJITHSHËM .....	18
<b>NENI 26</b> ZGJEDHJET-ROTACIONI .....	20

## **KAPITULLI V**

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE MBULIMI TERRITORIAL.....	22
---	----

<b>NENI 27</b> ORGANIZIMI DHE ROLI I DEGËS SË KRYQIT TË KUQ TË KOSOVËS.....	22
<b>NENI 28</b> KUVENDI I DEGËS.....	22
<b>NENI 29</b> SEANCAT E KUVENDIT TË DEGËS.....	23
<b>NENI 30</b> PROCEDURAT .....	23
<b>NENI 31</b> SHPËRBËRJA .....	23
<b>NENI 32</b> KRYESIA E DEGËS .....	24
<b>NENI 33</b> KOMPETENCATE KRYESISË SË DEGËS .....	24
<b>NENI 34</b> PROCEDURAT .....	25
<b>NENI 35</b> KRYETARI I DEGËS .....	25
<b>NENI 36</b> KOMISIONI FINANCIAR I DEGËS .....	26
<b>NENI 37</b> SEKRETARI I DEGËS.....	26

## **KAPITULLI VI**

PAJTUESHMËRIA, INTEGRITETI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE.....	28
---	----

<b>NENI 38</b> .....	28
----------------------	----

## **KAPITULLI VII**

ÇËSHTJET FINANCIARE .....	29
---------------------------	----

<b>NENI 40</b> FINANCAT .....	29
-------------------------------	----

<b>NENI 41</b> .....	30
----------------------	----

## **KAPITULLI VIII**

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE.....	31
---	----

<b>NENI 42</b> .....	31
----------------------	----

<b>NENI 43</b> SHPËRBËRJA .....	31
---------------------------------	----

<b>NENI 44</b> .....	31
----------------------	----

<b>NENI 45</b> .....	32
----------------------	----

<b>NENI 46</b> .....	32
----------------------	----

# KAPITULLI I:

## IDENTITETI I SHOQATËS KOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### HYRJE

Kryqi i Kuq i Kosovës është Shoqatë e pavarur, humanitare, vullnetare dhe joprofitabile, e themeluar në vitin 1945.

Kryqi i Kuq i Kosovës vepron në bazë të Ligjit Nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës ( Gazeta Zyrtare Nr. 74/ 20 korrik 2010).

Shkurtimi i emërtimit të Kryqit të Kuq të Kosovës është "KKK".

KKK veprimtarinë e vet e mbështet në parimet e Ligjit Ndërkombëtar Humanitar, gjegjësisht të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokolleve Shtesë të vitit 1977, si dhe në Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Kushtetutës së Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Rezolutave të Këshillit të Delegatëve dhe vendimeve të Kuvendit të Përgjithshëm të Federatës dhe Statutit të Lëvizjes.

### I. PARIMET THEMELORE

#### HUMANITETI

E lindur nga dëshira për t'u dalë në ndihmë të plagosurve në fushëbetejë pa dallim, Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (në tekstin e mëtejshëm: Lëvizja) përpiqet, në rrafshin ndërkombëtar dhe kombëtar dhe në çdo rrethanë, t'i parandalojë dhe lehtësojë vuajtjet e njerëzve. Ajo synon ta mbrojë jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe ta sigurojë respektimin e tyre. Mbështetë mirëkuptimin e ndërsjellë, miqësinë, bashkëpunimin dhe një paqe të qëndrueshme midis të gjithë popujve.

#### PAANËSIA

Lëvizja nuk bën asnjë dallim për arsye kombësie, race, feje, gjendje shoqërore apo përkatësie politike. Përpiqet t'i zbusë vuajtjet e njerëzve, duke qenë e udhëhequr kryekëput nga nevojat e tyre, dhe t'i jepet përparësi rasteve më urgjente.

#### NEUTRALITETI

Me qëllim që të gëzojë gjithnjë besimin e të gjithëve, Lëvizja i shmanget pjesëmarrjes në armiqësitë dhe në çfarëdo polemike të karakterit politik, racor, fetar apo ideologjik.

## **PAVARËSIA**

Lëvizja është e pavarur. Duke qenë ndihmëse e pushteteve publike në veprimtaritë e tyre humanitare dhe duke iu nënshtruar ligjeve të vendeve përkatëse, shoqatat kombëtare duhet, megjithatë, të ruajnë një autonomi që u bën të mundur atyre të veprojnë gjithnjë sipas parimeve të Lëvizjes.

## **SHËRBIMI VULLNETAR**

Është lëvizje vullnetare për ndihmë e cila nuk nxitet në asnjë mënyrë nga dëshira për të përfituar.

## **UNITETI**

Mund të ekzistojë vetëm një shoqatë e Kryqit të Kuq ose Gjysmëhënës së Kuqe në të njëjtin vend. Ajo duhet të jetë e hapur për të gjithë dhe të shtrijë veprimtarinë e saj humanitare në tërë territorin.

## **UNIVERSALITETI**

Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, në gjirin e së cilës të gjitha shoqatat kanë të drejta të barabarta dhe detyrë të ndihmojnë njëra-tjetrën, është e shtrirë në mbarë botën.

## **II. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **NENI 1**

### **MISIONI I KRYQIT TË KUQ TË KOSOVËS**

1. Kryqi Kuq i Kosovës ka për mision që të lehtësojë vuajtjet njerëzore të individëve dhe bashkësive të rrezikuara përmes programeve të fokusuara, prioritare dhe të qëndrueshme, si ndihmëse e autoriteteve qendrore dhe lokale, pa dallim gjinie, origjine etnike, kombësie, bindjeve fetare, prapavijave sociale, moshës, paaftësisë, gjuhës apo rrethanave të ngjashme në përputhje me:

- Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollet e tyre shtesë,
- Statutet e Lëvizjes së Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe Gjysmëhënës së Kuqe (në veçanti nenet 3 dhe 4 të Statuteve),
- Rezolutat e miratuara nga mbledhjet statutore të Lëvizjes dhe korniza strategjike e FNKKGJK,
- Ligjet dhe marrëveshjet kombëtare në fuqi.

2. Kryqi i Kuq i Kosovës është Shoqatë ndihmëse e autoriteteve vendore në fushën humanitare në mbarë vendin dhe si e tillë gëzon përkrahjen e Institucioneve Qeveritare.

## **NENI 2**

### **DETYRAT**

#### **1. KRYQI I KUQ I KOSOVËS:**

- 1.1. Kryen detyrat që dalin nga dispozitat e Konventave të Gjenevës dhe Protokollet Shtesë;
- 1.2. Organizon, nxit dhe aftëson qytetarët për ruajtjen e shëndetit, parandalimin e varësive dhe përmirësimin e kushteve të jetesës;
- 1.3. Punon në motivimin, avancimin dhe masivizimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Kosovës, mbi parimet e vullnetarizmit, anonimitetit dhe dhurimit falas;
- 1.4. Kontribuon në zbutjen e problemeve sociale, ofrimin e shërbimeve për aftësimin e grupeve më të cenueshme të shoqërisë;
- 1.5. Merr pjesë në sigurimin dhe bën shpërndarjen e ndihmave humanitare të shoqatave të tjera nacionale, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Federatës Ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, organizatat humanitare ndërkombëtare dhe vendore dhe sektori i korporatave;
- 1.6. Siguron përkujdesje shëndetësore dhe organizon, mbledh dhe shpërndan ndihmat humanitare dhe shëndetësore qytetarëve për të zbutur dhe eliminuar pasojat e fatkeqësive natyrore, epidemive, katastrofave dhe konflikteve të armatosura;
- 1.7. Merr pjesë në aksione të solidaritetit ndërkombëtar në rast të fatkeqësive elementare dhe të tjera;
- 1.8. Aftëson dhe ndihmon popullatën se si të veprojnë në rast të katastrofave, organizon dhe aftëson ekipe dhe njësi për reagim gjatë katastrofave;
- 1.9. Organizon dhe udhëheq punën e Shërbimit të Kërkimit - Rivendosjen e lidhjeve familjare;
- 1.10. Promovon Parimet Themelore të Lëvizjes, Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë, dhe respektimin e Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe vlerave humane;
- 1.11. Bën aftësimin e popullatës për dhënien e ndihmës së parë;
- 1.12. Organizon kurse të ndihmës së parë për sigurinë në punës dhe kurse të tjera për nevojat e subjekteve juridike;
- 1.13. Organizon kurse të ndihmës së parë për kandidatët për shoferë të automjeteve;
- 1.14. Organizon, aftëson, përsos dhe kryen ripërtëritjen e njohurive të instruktorëve të ndihmës së parë;
- 1.15. Organizon shërbime dhe aftëson kuadro për t'u kujdesur për të sëmurët dhe personat e moshuar dhe zhvillon forma për mbrojtjen jashtë- institucionale të personave të moshuar;
- 1.16. Me institucionet dhe organizatat kompetente merr pjesë në pranimin, akomodimin dhe përkujdesjen e popullatës së goditur dhe të pambrojtur, emigrantët, refugjatët, azilkërkuesit, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, viktimat e dhunës familjare;
- 1.17. Bashkëpunon me autoritetet qeveritare dhe organizatat kompetente për respektimin e të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq;

- 1.18. Bën vlerësimin e nevojave të komunitetit dhe në mënyrë të duhur ofron ndihmë, kurse për të mirën gjithëpërfshirëse kryen edhe punë të tjera të përcaktuara sipas dispozitave ligjore;
  - 1.19. Informon publikun për aktivitetet e veta;
  - 1.20. Bashkëpunon me Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Shoqatat Nacionale të Kryqit të Kuq dhe me organe të tjera, organizata dhe agjenci humanitare.
2. Veprimtaria e Kryqit të Kuq të Kosovës është me rëndësi publike për Republikën e Kosovës, kurse qëllimet e përcaktuara dhe detyra humanitare në fushën e shëndetësisë, mbrojtjes së të mirave materiale dhe shpëtimin e personave nga katastrofat natyrore, konfliktet e armatosura dhe raste të tjera të dhunës, rivendosjen e lidhjeve familjare, mbrojtjen sociale, edukimin dhe arsimimin, si dhe promovimin e së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, Kryqi i Kuq i Republikës së Kosovës i kryen si autorizime publike, duke u udhëhequr nga Parimet Themelore të Lëvizjes, Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë.

### **NENI 3**

#### **STATUSI LIGJOR KOMBËTAR**

1. Kryqi i Kuq i Kosovës ushtron veprimtarinë e tij si e vetmja Shoqatë Kombëtare e Kryqit të Kuq në Republikën Kosovë përmes degëve të Kryqit të Kuq të Kosovës, të cilat e bëjnë Kryqin e Kuq të Kosovës shoqatë unike.
2. KKK dhe degët e saj janë të përkushtuara që t'i mbulojnë të gjitha nevojat humanitare në tërë territorin e Kosovës.
3. Kryqi i Kuq i Kosovës është Shoqatë ndihmëse e autoriteteve vendore në fushën humanitare në mbarë vendin dhe si i tillë gëzon përkrahjen e Institucioneve Qeveritare. Institucionet Qeveritare në të gjitha kohërat respektojnë zbatimin e parimeve themelore të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe nga Kryqi i Kuq i Kosovës (neni 5 i Ligjit nr. 03/L-179, Ligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës).
4. Kryqi i Kuq i Kosovës ka selinë në Prishtinë, Rr. Enver Zymberi, nr. 24.

### **NENI 4**

#### **MARRËDHËNIET ME KOMPONENTËT TJERË TË LËVIZJES**

1. Kryqi i Kuq i Kosovës bashkëpunon drejtpërdrejtë me komponentët e Lëvizjes, ka të drejtë dhe obligim që të përfaqësojë anëtarët dhe interesat e veta në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC) dhe Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (IFRC).



## 2. Kryqi i Kuq i Kosovës i përmbushë obligimet sipas:

- Parimeve Themelore dhe Statutet e Lëvizjes së Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe Gjysmëhënës së Kuqe (në veçanti Neni 3 dhe 4),
- Rezolutat e miratuara nga Këshilli i Delegatëve dhe Konferenca Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe,
- Kushtetuta e IFRC,
- Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe Bordit Drejtues të IFRC.

## **NENI 5 MARRËVESHJET**

Kryqi i Kuq i Kosovës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me organizata, sidomos me autoritete vendore të Kosovës, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e shërbimeve publike. Këto marrëveshje bëhen me shkrim dhe në asnjë mënyrë nuk e obligojnë Kryqin e Kuq të Kosovës të veprojë në kundërshtim me Parimet Themelore të Lëvizjes.

## **NENI 6 EMBLEMA E KRYQIT TË KUQ TË KOSOVËS**

1. Emblema e Kryqit të Kuq të Kosovës është Kryqi i Kuq me pesë katrorë të barabartë në sfond të bardhë.
2. Kryqi i Kuq i Kosovës përdorë shenjën e Kryqit të Kuq në përputhje me nenin 6 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 74/ 20 korrik 2010), si dhe nenin 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-180 për Përdorimin dhe Mbrojtjen e Emblemës të Kryqit të Kuq emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve (Gazeta Zyrtare Nr. 74/20 korrik 2010), në pajtim me Konventat e Gjenevës të vitit 1949, me Protokollet e tyre Shtesë dhe me Rregulloret e vitit 1991 mbi përdorimin e emblemës nga Shoqatat Kombëtare, si dhe Rregullores së brendshme për përdorimin e emblemës dhe logos nga stafi, anëtarët dhe vullnetarët.
3. Logoja e KKK është shenja heraldike e KK në prapavijë të bardhë, e shoqëruar në emrin Kryqi i Kuq i Kosovës dhe Red Cross of Kosova.

## **KAPITULLI II:**

### **ANËTARËT**

#### **NENI 7**

#### **ANËTARËSIMI**

1. Anëtarësimi është status formal-juridik në Kryqin e Kuq të Kosovës.
2. Anëtarësimi në Kryqin e Kuq të Kosovës është vullnetar dhe i hapur për të gjithë, pa asnjë diskriminim të bazuar në racë, gjini, besim fetar, gjuhë, klasë apo ide politike, kombësie, bindjeve seksuale, prapavijave sociale, moshës dhe nevoja te veçanta.
3. Anëtar i Kryqit të Kuq të Kosovës mund të jetë çdo person që pranon këtë statut dhe vullnetarisht nënshkruan fletëaplikimin për anëtarësim.
4. Degët e KKK mbajnë përgjegjësi për azhurnimin e listës të anëtarëve.
5. Anëtari aktiv i Kryqit të Kosovës është person i cili në mënyrë aktive është i përfshirë në punën e Kryqit të Kuq të Kosovës, mbështet dhe kontribuon për zhvillimin e Kryqit të Kuq të Kosovës, mund të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organet dhe trupat e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe paguan anëtarësim vjetor.
6. Anëtari ndihmës është personi i cili nuk është i përfshirë aktivisht në punën e Kryqit të Kuq të Kosovës, por me pagesën e anëtarësimit apo në mënyrë tjetër ndihmon dhe mbështet Shoqatën Kombëtare dhe ka të drejtën të jetë i informuar në mënyrë periodike për të gjitha aspektet e punës së Shoqatës Kombëtare, dhe nuk mund të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organet dhe trupat e Kryqit të Kuq të Kosovës, derisa nuk angazhohet në mënyrë aktive në punën e Kryqit të Kuq të Kosovës.
7. Anëtar nderi është personi që ndihmon shoqatën kombëtare dhe me meritat dhe mbështetjen e tij kontribuon në mënyrë të veçantë në zhvillimin e Kryqit të Kuq të Kosovës, nuk mund të zgjedhë e as të jetë i zgjedhur në organet dhe trupat e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe nuk është i obliguar për të paguar tarifën vjetore të anëtarësimit.
8. Anëtar nderi dhe kryetar nderi mund të shpallë Kryesia Qendrore e Kryqit të Kuq të Kosovës.

#### **NENI 8**

#### **OBLIGIMET E ANËTARËVE**

##### **1. ANËTARËT KANË KËTO OBLIGIME:**

- 1.1. Të respektojnë dhe shpërndajnë Parimet Themelore të Lëvizjes së KK/GJK;
- 1.2. Të respektojnë rregullat, politikat dhe procedurat e Shoqatës Kombëtare për anëtarë;
- 1.3. Të avancojnë dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në punën e Kryqit të Kuq të Kosovës;
- 1.4. Të pranojnë dhe respektojnë Statutin e Shoqatës Kombëtare;
- 1.5. Të respektojnë dhe mbrojnë emblemën e Kryqit të Kuq të Kosovës;
- 1.6. Të paguajnë tarifë vjetore për anëtarësim.

## **NENI 9**

### **TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE AKTIVË:**

#### **1. ANËTARËT AKTIVË KANË TË DREJTË:**

- 1.1. Të zgjedhin dhe të zgjedhën në organet drejtuese, përveç atyre të cilët janë të punësuar në KKK;
- 1.2. Të marrin pjesë dhe të votojnë në Kuvendet e degëve të KKK dhe nëse zgjedhën si delegat, edhe në Kuvendin e Përgjithshëm të KKK;
- 1.3. Të paraqesin mendime dhe propozime për avancimin e punës së Shoqatës në çdo nivel të organizimit të saj;
- 1.4. Të drejtën të merr njoftime dhe të merr pjesë në takime përkatëse.

#### **2. ANËTARËT AKTIVË KANË PËRGJEGJËSINË:**

- 2.1. Të mbështesin dhe të përhapin njohuritë për Parimet Themelore të Lëvizjes;
- 2.2. Të përkrahin punën e Shoqatës;
- 2.3. Të njohin dhe të respektojnë Statutin e Shoqatës;
- 2.4. Të paguajnë anëtarësinë vjetore, sipas vlerës së përcaktuar nga Kryesia Qendrore;
- 2.5. Të marrin pjesë në mënyre aktive në punën e Shoqatës Kombëtare, duke ruajtur dhe afirmuar imazhin e saj;
- 2.6. Të respektojnë Kodin e mirësjelljes për anëtarët.

## **NENI 10**

### **HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT AKTIV**

1. Anëtari aktiv mund ta humb statusin e anëtarit të KKK nëse:
  - 1.1. Jep dorëheqje me shkrim;
  - 1.2. Nuk paguan anëtarësinë deri në fund të secilit vit kalendarik;
  - 1.3. Bën shkelje të rëndë të Parimeve Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJK;
  - 1.4. Bën shkelje të Statutit të KKK;
  - 1.5. Kryerjen veprimeve të cilat cenojnë rëndë imazhin e Shoqatës;
  - 1.6. Bën shkelje të Kodit e Mirësjelljes;
  - 1.7. Në rast të vdekjes.
2. Vendimin për përjashtimin e anëtarit e merrë Kryesia e Degës së KKK. Çdo anëtar i përjashtuar duhet të informohet saktë dhe me shkrim për shkaqet e përjashtimit nga Kryesia e Degës së KKK.
3. Anëtari aktiv duhet të marrë një përkujtues për pagesën e anëtarësisë një muaj para skadimit të afatit.
4. Çdo anëtar i përjashtuar ka të drejtë të apelojë në Kryesinë Qendrore në afat prej 30 ditësh prej ditës së përjashtimit.
5. Kryesia Qendrore vendos për rregullat e procedurës për dëgjim të ankesave.

## **KAPITULLI III:**

### **VULLNETARËT**

#### **NENI 11**

### **VULLNETARËT**

1. Vullnetarët për KKK janë fuqia themelore për përmbushjen e Misionit të KKK.
2. KKK është e hapur për të gjithë ata që duan të jenë vullnetarë pa asnjë lloj diskriminimi të bazuar në gjini, origjinë etnike, kombësi ose shtetësi, moshë, paaftësi, gjuhë, opinione politike, besime fetare, prejardhje sociale ose ndonjë arsye tjetër.
3. Angazhimi individual i vullnetarit në Shoqatën Kombëtare dallon, kjo nënkupton që vullnetarët mund të jenë anëtarë, dhe personeli mund të jetë vullnetar për Shoqatën Kombëtare, por që këto role janë të dallueshme.
4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve:
  - 4.1 Të drejtat e vullnetarëve:
    - 4.1.1 Të përkrahen dhe të trajnohen mjaftueshëm për të kryer detyra vullnetare;
    - 4.1.2 Të jenë pjesëmarrës në hartimin dhe përmirësimin e aktiviteteve në të cilat ata janë të përfshirë;
    - 4.1.3 Të mbrohen gjatë angazhimeve me KKK (duke përfshirë sigurinë; mbrojtjen nga abuzimi, ngacmimi dhe ngacmimi seksual, si dhe mbështetjen psiko-sociale);
    - 4.1.4 Rimbursimin për shpenzimet e arsyeshme të shkaktuara gjatë vullnetarizmit (sipas Politikës për Vullnetarë të KKK-së).
  - 4.2 Përgjegjësitë e vullnetarit:
    - 4.2.1 Të veprojnë në pajtueshmëri me Parimet Themelore të Lëvizjes;
    - 4.2.2 Të respektojnë rregulloret e Shoqatës Kombëtare në lidhje me përdorimin e emblemës dhe parandaloj keqpërdorimin;
    - 4.2.3 Të veprojnë në pajtueshmëri me politikën e vullnetarëve të KKK dhe rregulloret e programeve përkatëse.

## **KAPITULLI IV:**

### **UDHËHËQJA (QEVERISJA DHE MENAXHIMI)**

#### **NENI 12**

#### **KUVENDI I PËRGJITHSHËM**

1. Kuvendi Përgjithshëm përfaqëson tërësinë e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe përbëhet nga delegatët e deleguar.
2. Delegatët për Kuvendin e Përgjithshëm zgjedhen nga Kuvendet e degëve të KKK dhe Institucioneve përkatëse të nivelit qendror, puna e të cilëve ndërlidhet me veprimtarinë e KKK. Delegatët nga institucionet përkatëse delegohen me kërkesë me shkrim të Kryqit të Kuq të Kosovës.
3. Numri i delegatëve nga Degët përcaktohet me propozim të Kryesisë Qendrore të Kryqit të Kuq të Kosovës në përpjesëtim me madhësinë e Degës së KKK, duke pasur parasysh përfaqësimin adekuat gjinor, moshës dhe profileve.

#### **NENI 13**

1. Kuvendi i Përgjithshëm është organi më i lartë i Kryqit të Kuq të Kosovës dhe vendos për të gjitha çështjet strategjike për KKK.
2. Mandati i delegatit të Kuvendit është 4 (katër) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe një mandat.

#### **NENI 14**

#### **KOMPETENCAT E KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM**

1. Kuvendi i Përgjithshëm ka këto kompetenca:
  - 1.1. Miraton Statutin e Kryqit të Kuq të Kosovës;
  - 1.2. Siguron përmbushjen e Misionit dhe Vizionit, Strategjisë dhe politikat e veprimtarisë së Shoqatës Kombëtare;
  - 1.3. Miraton raportin e punës dhe financiar mes dy seancave;
  - 1.4. Miraton planin e punës dhe financiar për periudhën e ardhshme
  - 1.5. Miraton Rregulloren mbi funksionimin e Kuvendit të Përgjithshëm;
  - 1.6. Zgjedhë anëtarët e Kryesisë Qendrore nga radhët e delegatëve të Kuvendit sipas propozimit orientues të Kryesisë paraprake;
  - 1.7. Zgjedhë Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin;
  - 1.8. Zgjedhë Kryetarin dhe anëtarët e komisionit për financa.

## **NENI 15**

### **SEANCA E KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM**

1. Kuvendi i Përgjithshëm mblidhet më së paku çdo dy vjet në seanca të rregullta pune, ndërsa çdo katër vjet në seancë zgjedhore.
2. Kuvendi i Përgjithshëm mund të mblidhet në raste të jashtëzakonshme edhe me iniciativën e Kryetarit në marrëveshje me Kryesinë Qendrore ose me kërkesën e së paku 1\3 të delegatëve të Kuvendit të Përgjithshëm.
3. Në qoftë se kryetari nuk e thërret seancën, iniciativa e thirrjes duhet të mbështetet nga më shumë se 1/2 (gjysma) e anëtarëve të Kuvendit me të drejtën e votës për t'u mbajtur seanca.
4. Në qoftë se Kryetari apo Zëvendëskryetari nuk e kryeson seancën e jashtëzakonshme, ajo kryesohet nga anëtari më i moshuar nga radhët e iniciuesve.

## **NENI 16**

### **PROCEDURA E KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM**

1. Kuvendi i Përgjithshëm i merr të gjitha vendimet në prani të së paku 2/3 të delegatëve të saj dhe me votat e shumicës të delegatëve të pranishëm të cilët kanë të drejtë vote. Në të kundërtën caktohet seanca e re e Kuvendit brenda 48 orëve
2. Çdo delegat i Kuvendit të Përgjithshëm ka të drejtën e një vote.
3. Për pozitat qeverisëse, zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë.

## **NENI 17**

### **KRYESIA QENDRORE**

1. Kryesia Qendrore është organ që drejton Kryqin e Kuq të Kosovës ndërmjet sesioneve të Kuvendit të Përgjithshëm dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e organizatës.
2. Kryesia Qendrore përbëhet nga :
  - 2.1. Kryetari,
  - 2.2. Zëvendëskryetari dhe
  - 2.3. Anëtarët e Kryesisë të zgjedhur në Kuvend.
3. Numri i anëtarëve të Kryesisë së ardhshme caktohet me vendim të Kryesisë paraprake dhe mund t'i ketë 11 deri 15 anëtarë me mandat katërvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe një mandat.

## **NENI 18**

### **KOMPETENCAT E KRYESISË QENDRORE**

1. Kryesia Qendrore:
  - 1.1. Vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme për përmbushjen e qëllimeve të KKK;
  - 1.2. Zbaton politikën e përgjithshme të KKK për të cilën përgjigjet para Kuvendit të Përgjithshëm.
2. Kryesia Qendrore mblidhet së paku katër herë në vit dhe ka këto kompetenca:
  - 2.1. Përcaktimin e vizionit dhe drejtimin strategjik, dhe përcaktimin e qëllimeve të përgjithshme;
  - 2.2. Marrjen e vendimeve për planifikimin dhe burimet;
  - 2.3. Zhvillimin e një kulture organizative për të arritur qëllimet;
  - 2.4. Ushtron rol mbikëqyrës dhe monitorues mbi punën e Shoqatës;
  - 2.5. Miraton dhe siguron që politikat adekuate të qeverisjes për performancë dhe veprimtari organizative të qëndrueshme, me kosto efektive, ligjore dhe etike;
  - 2.6. Miraton planin e punës dhe atë financiar;
  - 2.7. Miraton raportin e punës dhe atë financiar;
  - 2.8. Mbikëqyrë xhirollogaritë në të gjitha nivelet dhe vendos për hapjen apo mbylljen e tyre;
  - 2.9. Sigurimin e strukturës së përshtatshme të degëve;
  - 2.10. Monitorimin e anëtarësisë dhe vullnetareve;
  - 2.11. Vendos mbi shumën e pagesës së anëtarësisë në KKK;
  - 2.12. Mbikëqyrë veprimtarinë e degëve të KKK;
  - 2.13. Vendos për themelimin dhe shuarjen e degëve;
  - 2.14. Vendos për shpërbërjen e Kuvendit dhe Kryesisë së Degës dhe shpall zgjedhje të parakohshme nëse:
    - 2.14.1. Shkelen normat statutare dhe rregulloret e brendshme,
    - 2.14.2. Ka mosmarrëveshje të rënda në nivel dege,
    - 2.14.3. Nuk respekton vendimet e Kryesisë Qendrore,
    - 2.14.4. Për të gjitha veprimet tjera jo të mira të cilat i konstaton Kryesia Qendrore e KKK në bazë të raporteve nga komisionet e formuara për shqyrtim.
  - 2.15. Përcakton kriteret për pozitën e sekretarit të përgjithshëm;
  - 2.16. Emërimin, monitorimin e performancës dhe ndërprerjen e kontratës të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe Sekretarit të Degës bazuar në rekomandimet e Sekretarit të Përgjithshëm. Pjesa tjetër e ekipit / personelit menaxhues duhet të punësohet përmes procedurave të parapara me ligj dhe rregullore të brendshme mbikëqyruar nga Sekretari i Përgjithshëm;
  - 2.17. Sigurimi i qëndrueshmërisë organizative dhe monitorimi i financave, duke përfshirë sigurimin që Shoqata Kombëtare të ketë burime të ndryshme dhe të qëndrueshme të të ardhurave, të ngritura kryesisht në vend;

- 2.18. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin vendor;
  - 2.19. Mbikëqyrjen e menaxhimit të rrezikut dhe ngritjes së integritetit;
  - 2.20. Sigurimi i mekanizmave të nevojshëm për të hetuar dhe vepruar ndaj reagimeve të marra nga akterët kryesorë dhe anëtarët;
  - 2.21. Miraton vendime si organ i shkallës së dytë ndaj ankesave të shqyrtuara paraprakisht nga komisioni përkatës;
  - 2.22. Shqyrton dhe aprovon aktet e brendshme juridike dhe Kodin e Mirësjelljes;
  - 2.23. Siguron që statuti dhe rregulloret e brendshme janë të azhurnuara;
  - 2.24. Shqyrton, propozon ndryshime dhe plotësime në Statutin e KKK;
  - 2.25. Formon komisione të nevojshme për realizimin e detyrave të KKK;
  - 2.26. Përcakton kahet e bashkëpunimit me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, si dhe Shoqatat Kombëtare.
3. Miraton Rregulloren për mirënjohje dhe falënderime për organizata dhe individë për kontributin e tyre në aktivitetet e KKK, si dhe për donatorë.
  4. Miraton aktet normative mbi strukturën organizative, sistematizimin e vendeve të punës dhe të ardhurave personale të të punësuarve në shërbimet profesionale të KKK, në nivel qendror dhe lokal.

## **NENI 19**

### **MBLEDHJET E KRYESISË QENDRORE**

1. Kryesia Qendrore mban mbledhje të rregullta me thirrjen e Kryetarit së paku një herë në tre muaj.
2. Kryesia mund të mbajë mbledhje edhe jashtë radhës me kërkesën e Kryetarit, 1/3 të anëtarëve të saj ose me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm drejtuar Kryetarit.

## **NENI 20**

### **PROCEDURAT E KRYESISË QENDRORE**

1. Kryesia Qendrore i merë të gjitha vendimet në prani të më shumë se gjysmës të anëtarëve të vet dhe me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
2. Çdo anëtar i Kryesisë Qendrore ka të drejtën e një vote.
3. Në mungesë të kuorumit, mbledhja shtyhet, mbledhja e re mbahet brenda afatit prej 30 ditësh. Në raste emergjente, Kryesia vendos sipas Planit Operativ Emergjent.



## **NENI 21**

### **KRYETARI**

1. Kryetari është personaliteti më i lartë i KKK.
2. Kryetari është përgjegjës para Kuvendit të Përgjithshëm për të siguruar se KKK ushtron objektivat e përcaktuara me Statut. Kryetari vepron nën autoritetin e Kuvendit të Përgjithshëm dhe Kryesisë Qendrore për drejtimin e KKK në përputhje me vendimet.
3. Funkcionet e Kryetarit janë:
  - 3.1. Të thërret dhe të kryesojë seancat e punës të Kuvendit të Përgjithshëm dhe mbledhjet e Kryesisë Qendrore;
  - 3.2. T'i paraqesë Kuvendit të Përgjithshëm një pasqyrë të gjendjes të KKK;
  - 3.3. Të bashkërendojë punën e organeve të KKK;
  - 3.4. Të përfaqësojë KKK në rrafshin kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
  - 3.5. Të zbatojë çdo detyrë tjetër të besuar nga Kuvendi i Përgjithshëm ose nga Kryesia Qendrore;
  - 3.6. Kryetari mund t'ia kalojë një pjesë të këtyre detyrave, të shprehura në këtë nen, Zëvendëskryetarit;
  - 3.7. Pozita e Kryetarit është vullnetare (pa pagesë);
  - 3.8. Kohëzgjatja e mandatit të zgjedhur është katër vite me mundësi për një mandat të dytë të njëpasnjëshëm (dy mandate të njëpasnjëshme), pavarësisht pozitës udhëheqëse në nivel qendror apo lokal.
4. Në rast të mungesës së Kryetarit ose në rast se Kryetari nuk është në gjendje të kryejë këtë funksion për shkaqe shëndetësore, funksionin e Kryetarit e kryen Zëvendëskryetari deri në kthimin e tij, ose deri në seancën e radhës së Kuvendit të Përgjithshëm.

## **NENI 22**

### **ZËVENDËSKRYETARI**

1. Zëvendëskryetari ndihmon kryetarin në kryerjen e detyrave të përcaktuara, kryen punë të tjera të deleguara nga Kryetari dhe në mungesë të tij e zëvendëson në të gjitha funksionet e përcaktuara me këtë statut.
2. Mandati i Zëvendëskryetarit zgjat 4 (katër) vjet, me mundësinë për një mandat të dytë të njëpasnjëshëm.
3. Zgjedhja e Zëvendëskryetarit kryhet me votim të fshehtë.
4. Zëvendëskryetari për punën e tij përgjigjet para Kuvendit dhe Kryesisë Qendrore të Shoqatës Kombëtare.
5. Pozita e Zëvendëskryetarit është vullnetare (pa pagesë).

## **NENI 23**

### **KOMISIONI PËR FINANCA**

1. Komisioni për financa emërohet nga Kuvendi i Përgjithshëm dhe ka mandat katër vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat (dy mandate të njëpasnjëshme).
2. Komisioni përbëhet nga kryetari i komisionit dhe katër anëtarë, nga radhët e ekspertëve të fushës përkatëse.
3. Anëtarët e komisionit financiar duhet të jenë anëtarë të KKK, por jo delegatë të Kuvendit.
4. Komisioni financiar kontrollon veprimtarinë materiale-financiare në të gjitha nivelet e organizimit të KKK.

## **NENI 24**

### **KOMPETENCAT E KOMISIONIT PËR FINANCA**

1. Komisioni për financa:
  - 1.1. Këshillon për të gjitha çështjet financiare që ndikojnë në punën e Kryqit të Kuq të Kosovës;
  - 1.2. Vlerëson raportin dhe planin financiar të Kryqit të Kuq të Kosovës;
  - 1.3. Rekomandon Kryesisë Qendrore për ndërmarrjen e masave të duhura financiare dhe qëllimin e tyre;
  - 1.4. Përcjellë qarkullimin e kontributeve financiare;
  - 1.5. Këshillon Sekretarin e Përgjithshëm dhe Kryesin Qendrore për zbatimin e vendimeve për punën financiare të Kryqit të kuq të Kosovës që i ka miratuar Kuvendi i Përgjithshëm;
  - 1.6. Raporton për punën financiare të Kryqit të Kuq të Kosovës për Kryesin Qendrore;
  - 1.7. Përkrahë Sekretarin e Përgjithshëm në hartimin e planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të dala nga raporti final i auditorit të jashtëm ;
  - 1.8. Me kërkesë të kryetarit të Kryqit të Kuq të Kosovës dhe sekretarit të përgjithshëm këshillon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve si dhe çështjet tjera financiare që kanë ndikim në performancën e Kryqit të kuq të Kosovës;
  - 1.9. Kohëzgjatja e mandatit të zgjedhur është katër vite me të drejtë rizgjedhje (dy mandate të njëpasnjëshme), pavarësisht pozitës udhëheqëse në nivel qendror apo lokal.

## **NENI 25**

### **SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

1. Roli i Sekretarit të Përgjithshëm është të ekzekutojë vendimet e qeverisjes dhe të jetë përgjegjës për aktivitetet e përditshme.
2. Udhëzohet nga Kryesia Qendrore dhe është përgjegjës për:
  - 2.1. Komunikimin e vendimeve, qëllimin, objektivat, strategjinë dhe politikat për të gjithë stafin;

- 2.2. Zbatimin dhe përcjelljen e vendimeve të qeverisjes;
  - 2.3. Menaxhimin e aktiviteteve ditore dhe zhvillimin e programeve;
  - 2.4. Hartimin e planit të buxhetit dhe raportit financiar;
  - 2.5. Raportim periodik dhe vjetore të rezultateve në qeverisje;
  - 2.6. Të punojë me qeverisjen për të siguruar përfaqësimin e jashtëm konsistent dhe efektiv të Shoqatës Kombëtare;
  - 2.7 Mbikëqyrë implementimin e projekteve dhe programeve të KKK;
  - 2.8 Me vendim obligon sekretarët e degëve për zbatimin dhe raportimin për projekte dhe programe të caktuara;
  - 2.9 Mbikëqyrë implementimin e rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore në nivel qendror dhe lokal;
  - 2.10 Propozon strukturën e shërbimit profesional dhe e paraqet për miratim në Kryesinë Qendrore;
  - 2.11 Mbikëqyrë punën e përditshme të shërbimit profesional të Zyrës Qendrore dhe sekretarët në degë;
  - 2.12 Është përgjegjës për vlerësimin e performancës të të gjithë të punësuarve në nivel qendror dhe për sekretarët e degëve;
  - 2.13. Lidh dhe shkëput kontrata me punonjësit e shërbimit profesional, në nivel qendror dhe lokal;
  - 2.14. Inicion procedura disiplinore për verifikimin e përgjegjësisë për të punësuarit në Zyrën Kryesore dhe sekretarët e degëve të Kryqit të Kuq të Kosovës për mos realizimin e detyrave dhe mos zbatimin e vendimeve të Kryesisë Qendrore të Kryqit të Kuq të Kosovës;
  - 2.15. I rekomandon Kryesisë Qendrore masat disiplinore ndaj sekretarëve të degëve në rast se Kryesia e degës nuk inicion procedura disiplinore për rastin në fjalë;
  - 2.16. Miraton rendin shtëpiak të shërbimit;
  - 2.17. Është përfaqësues i autorizuar i KKK në lidhje me palët e treta;
  - 2.18. Lidhë kontrata dhe memorandume të bashkëpunimit në përputhje me vendimet e marra dhe politikat e Shoqatës Nacionale;
  - 2.19. Mban të informuar Kryetarin;
  - 2.20 Nuk është anëtar i Kryesisë Qendrore;
  - 2.21. Është Sekretar i Kuvendit të Përgjithshëm dhe i Kryesisë Qendrore;
  - 2.22. Duhet të marrë pjesë në seancat e Kuvendit të Përgjithshëm dhe Kryesisë Qendrore në cilësinë e këshilltarit, pa të drejtë vote;
  - 2.24. Emërohet dhe shkarkohet nga Kryesia Qendrore sipas kriterëve të përcaktuara më parë.
3. Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm është 4 vjet me mundësi të riemërimit.

## ZGJEDHJET – ROTACIONI – PROFILET

### NENI 26

#### ZGJEDHJET-ROTACIONI

1. Zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së KKK dhe numrit të anëtarëve bëhet nga Kuvendi i Përgjithshëm me shumicën e thjeshtë të votave të delegatëve të pranishëm. Votimi bëhet me vota të fshehta. Kuvendi mund të vendos edhe ndryshe.
2. Për numrin e anëtarëve të Kryesive lokale vendos Kryesia Qendrore.
3. Për nivel lokal numri i anëtarëve të Kryesisë bazohet në madhësinë e degës.
4. Kryesia paraprake e KKK i propozon kuvendit nga një kandidatë për kryetar dhe zëvendëskryetar, ndërsa delegatët e Kuvendit të Përgjithshëm të KKK bëjnë propozime të tjera për kryetar dhe zëvendëskryetar. Zgjedhja bëhet me votim të fshehtë.
5. Zgjedhjet për të njëjtat poste në degët e KKK bëhen nga Kuvendet e degëve të KKK me procedurë të njëjtë sikurse për Kuvendin e Përgjithshëm të KKK.
6. Kohëzgjatja e mandatit të zgjedhur është katër vite me të drejtë rizgjedhje (dy mandate të njëpasnjëshme), pavarësisht pozitës udhëheqëse në nivel qendror apo lokal.
7. Kuvendi i Përgjithshëm zgjedh 5 anëtarët e Komisionit Financiar për nivel qendror dhe emëron kryetarin e komisionit nga anëtarët e përzgjedhur.

#### PROFILET - KRITERET

1. Biografia e kandidatëve duhet t'i dërgohet Kryesisë aktuale para se të mbahen zgjedhjet për postet e rëndësishme (Kryetari, Zëvendëskryetari dhe anëtarët e Kryesisë) në nivel qendror dhe lokal.
2. Kandidatët zgjedhen në bazë të kriterëve të mëposhtme:
  - 2.1. Për anëtarë të Kryesisë në nivel qendror dhe lokal:
    - 2.1.1. Vullnetar në KKK, minimumi pesë vite;
    - 2.1.2. Anëtarë i KKK, minimumi tri vite;
    - 2.1.3. Eksperienca dhe kontributi në Kryqin e Kuq të Kosovës;
    - 2.1.4. Në rast se një anëtar i qeverisjes në KKK, merr post në ndonjë parti politike, ai/ajo automatikisht humb anëtarësimin në pozita udhëheqëse të KKK;
    - 2.1.5. Të mos ketë konflikte interesi për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare që cenojnë lirinë e tij\ saj për të zbatuar detyrat e tij\ saj në përputhje me Parimet Themelore të Lëvizjes;
    - 2.1.6. Anëtarët e zgjedhur në organet qeverisëse të Kryqit të Kuq të Kosovës në nivel qendror dhe lokal janë të obliguar të pranojnë dhe nënshkruajnë kodin e mirësjelljes;

3. Përzgjedhja e anëtarëve të Kryesisë bëhet sipas fushë veprimtarisë humanitare dhe misionit të KKK.
4. Për pozitën e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit:
  - 4.1. Të jetë vullnetar në KKK, së paku dhjetë vite;
  - 4.2. Të ketë reputacion të lartë, integritet, të jetë figurë e pastër morale pa sjellje që bie ndesh me Parimet Themelore të Lëvizjes;
  - 4.3. Të ketë nivel superior të arsimit dhe veti personale shumë të mira;
  - 4.4. Të ketë përvojën e duhur në marrëdhënie me Institucionet vendore, në marrëdhëniet ndërkombëtare, në paraqitje dhe komunikim me publikun dhe me të gjitha organizmat me të cilat lidhet puna e KKK;
  - 4.5. Të jetë konsideruar i suksesshëm në veprimtarinë e tij, në qoftë se ka qenë në të njëjtin pozitë për të cilën paraqet kandidaturën ose në ndonjë pozitë tjetër në KKK ose diku tjetër;
  - 4.6. Në rast se merr post në ndonjë parti politike, ai/ajo automatikisht humb anëtarësimin në pozita udhëheqëse të KKK;
  - 4.7. Të mos ketë konflikte interesi për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare që cenojnë lirinë e tij\ saj për të zbatuar detyrat e tij\ saj në përputhje me Parimet Themelore të Lëvizjes;
  - 4.8. Anëtarët e zgjedhur në organet qeverisëse të Kryqit të Kuq të Kosovës, në nivel qendror dhe lokal, janë të obliguar të pranojnë dhe nënshkruajnë kodin e mirësjelljes;
5. Përzgjedhja e anëtarëve të Kryesisë bëhet sipas fushë veprimtarisë humanitare dhe misionit të KKK.

## **KAPITULLI V:**

### **STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE MBULIMI TERRITORIAL**

#### **NENI 27**

#### **ORGANIZIMI DHE ROLI I DEGËS SË KRYQIT TË KUQ TË KOSOVËS**

Kryqi i Kuq i Kosovës ushtron veprimtarinë e tij si e vetmja Shoqatë Kombëtare e Kryqit të Kuq në Kosovë përmes degëve të Kryqit të Kuq të Kosovës, të cilat e bëjnë Kryqin e Kuq të Kosovës shoqatë unike. KKK dhe degët e saj janë të përkushtuara që t'i mbulojnë të gjitha nevojat humanitare në tërë territorin e Kosovës.

1. Dega është njësi e pandashme e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe funksionon bazuar në aktet normative të KKK.
2. Dega themelohet me vendimin e Kryesisë Qendrore (neni 18.2.13) për të siguruar praninë e veprimtarisë së KKK në gjithë territorin e vendit duke pasur parasysh ndarjen administrative.
3. Dega përbëhet nga anëtarët e Kryqit të Kuq të Kosovës të regjistruar në territorin e saj të veprimit. Dega organizon veprimtarinë e vet në territorin përkatës konform Statutit.
4. Dega, në territorin e saj administrativ ku ka anëtarë dhe veprimtari të mjaftueshme, themelon Organizatë Themelore të drejtuara nga një këshill që zgjedhet nga përbërja e anëtarëve të saj.
5. Organizata Themelore është njësi organizative bazë të Degës dhe nuk mund të kenë pavarësi financiare.
6. Dega duhet të fuqizohet për të kryer në mënyrë efektive aktivitetet e veta.

#### **NENI 28**

#### **KUVENDI I DEGËS**

1. Kuvendi është organi më i lartë i Degës dhe përfaqëson tërësinë e anëtarëve të saj.
2. Kuvendi i degës i raporton Kryesisë Qendrore të KKK.
3. Kuvendi vendos për çështje me interes në nivel të degës duke respektuar vendimet, politikat dhe rregulloret e miratuara në nivel qendror.
4. Në territorin përkatës administrativ, Kuvendi i Degës përbëhet nga delegatët e degës së Kryqit të Kuq dhe institucionet me të cilat bashkëpunon Kryqi i Kuq.
5. Kryesia e Degës përcakton numrin e delegatëve, profilet dhe kriteret për përfaqësim në Kuvendin e degës.
6. Kuvendi i Degës zgjedh Kryetarin, Zëvendëskryetarin, Kryesinë dhe delegatët për Kuvendin e Përgjithshëm në harmoni me dispozitat e Statutit të Kryqit të Kuq të Kosovës.
7. Numri dhe profili i delegatëve të degës për Kuvendin e Përgjithshëm të KKK përcaktohet me vendim të posaçëm të Kryesisë Qendrore.
8. Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Degës është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.

## 9. Kompetencat e Kuvendit të Degës:

- 9.1. Diskuton dhe aprovon raportin e punës, planin e punës së Degës për periudhën në mes dy kuvendeve zgjedhore;
- 9.2. Miraton raportin dhe planin financiar mes dy kuvendeve;
- 9.3. Zgjedhë komisionin financiar të degës.

## **NENI 29**

### **SEANCAT E KUVENDIT TË DEGËS**

1. Kuvendi i Degës mban seanca të rregullta punuese çdo dy vjet.
2. Kuvendi i Degës mund të mbajë seancë në rast nevoje, me iniciativën e Kryetarit në marrëveshje me Kryesinë e Degës, me kërkesën e një të tretës (1/3) së delegatëve të Kuvendit apo me kërkesën e Kryesisë Qendrore të KKK-së.

## **NENI 30**

### **PROCEDURAT**

1. Kuvendi i Degës punon në qoftë se janë të pranishëm më shumë se 2/3 e numrit të përgjithshëm të delegatëve të Kuvendit me të drejtë vote dhe vendimet merren me shumicën e votave të delegatëve të pranishëm, me votim të hapur apo të mbyllur (sipas Rregullores së punës e Kuvendit Zgjedhor të Degës të KKK).
2. Në mungesë të kuorumit, seanca shtyhet. Seanca e re mbahet brenda afatit prej 30 ditësh sipas procedurës së paraparë. Çdo delegat i Kuvendit të Degës ka të drejtën e një vote.
3. Për pozitat e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Degës, zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë.

## **NENI 31**

### **SHPËRBËRJA**

1. Kryesia Qendrore në bazë të kompetencave nga (neni 18.2.13) mund të shpërbëjë Kuvendin e Degës të Kryqit të Kuq nëse:
  - 1.1. Shkelen normat statutare dhe rregulloret e brendshme;
  - 1.2. Nuk përmbush dhe nuk zbaton politikat e miratuara, vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e nivelit qendror;
  - 1.3. Ka mosmarrëveshje të rënda në nivel dege;
  - 1.4. Nuk funksionojnë sisteme të caktuara për vendosje dhe zhvillim të Kryqit të Kuq të Kosovës;
  - 1.5. Për të gjitha veprimet tjera jo të mira të cilat i konstaton Kryesia Qendrore e KKK, në bazë të raporteve nga komisionet e formuara për shqyrtim.

## **NENI 32**

### **KRYESIA E DEGËS**

1. Kryesia e Degës është organ që udhëheq me aktivitetet e KKK-së në nivel të Degës mes dy kuvendeve zgjedhore.
2. Kryesia e Degës përbëhet nga:
  - 2.1. Kryetari,
  - 2.2. Zëvendëskryetari dhe
  - 2.3. Anëtarët e kryesisë të zgjedhur në Kuvend të Degës.
3. Numri i anëtarëve të Kryesisë së degës caktohet me vendim të Kryesisë Qendrore.

## **NENI 33**

### **KOMPETENCATE KRYESISË SË DEGËS**

1. Kryesia e Degës ka këto kompetenca:
  - 1.1. Zbaton politikat e përcaktuara nga Kryesia Qendrore e KKK;
  - 1.2. Monitoron zbatimin e Kodit të Mirësjelljes për anëtarët, vullnetarët, dhe të punësuarit në nivel dege;
  - 1.3. Merr vendim për formimin e komisioneve të nevojshme dhe adekuate për realizimin e programeve të KKK;
  - 1.4. Shqyrton dhe aprovon raportet periodike të punës dhe financiar, planin e punës dhe financiar. Të njëjtat i përcjellë në nivel qendror për shqyrtim dhe aprovim;
  - 1.5. Siguron që përdorimi i mjeteve financiare dhe materiale janë në pajtim me parimet dhe politikat e KKK-së;
  - 1.6. Siguron të mos ketë shpenzime financiare jashtë planifikimit buxhetor;
  - 1.7. Propozon Kryesisë Qendrore tre kandidatë të mundshëm për pozitën e sekretarit të degës;
  - 1.8. Rekomandon Kryesisë Qendrore shkarkimin e sekretarit të degës;
  - 1.9. Mban kontakte të rregullta, bashkëpunon, informon Kryesinë Qendrore dhe zbaton vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e KKK.
2. Mbledhjet e Kryesisë së Degës
  - 2.1. Kryesia e Degës mban mbledhje të rregullt me thirrjen e kryetarit së paku një herë në tre muaj;
  - 2.2. Mbledhjet duhet përgatiten me materiale përkatëse dhe të njoftohet Kryesia Qendrore paraprakisht;
  - 2.3. Kryesia mund të mbaj mbledhje edhe jashtë radhës me kërkesën e kryetarit apo 1/3 e anëtarëve të saj dhe me kërkesën e Sekretarit të Degës, drejtuar Kryetarit;
  - 2.4. Mbledhja e Kryesisë së Degës mund të konvokohet edhe me kërkesën e Kryesisë Qendrore të KKK-së.



## **NENI 34**

### **PROCEDURAT**

1. Kryesia e degës punon në qoftë se janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të Kryesisë dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
2. Kryesia e Degës, të gjitha vendimet i merr në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm.
3. Çdo anëtar i Kryesisë së Degës ka të drejtën e një vote.
4. Në mungesë të kuorumit, mbledhja shtyhet. Mbledhja e re mbahet brenda afatit prej 7 ditësh sipas procedurës së paraparë. Në raste emergjente kryesia vendos edhe me më pak anëtarë.

## **SHPËRBËRJA**

1. Kryesia Qendrore në bazë të kompetencave nga neni 19.2.13 mund të shpërbëjë Kryesinë e degës të Kryqit të Kuq nëse:
  - 1.1. Shkelen normat statutare dhe rregulloret e brendshme;
  - 1.2. Nuk përmbush dhe nuk zbaton politikat e miratuara, vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e nivelit qendror;
  - 1.3. Ka mosmarrëveshje të rënda në nivel dege që pengojnë funksionimin e degës dhe dëmtojnë imazhin e KKK;
  - 1.4. Nuk funksionojnë sisteme të caktuara për vendosje dhe zhvillim të Kryqit të Kuq të Kosovës;
  - 1.5. Për të gjitha veprimet tjera jo të mira të cilat i konstaton Kryesia Qendrore e KKK, në bazë të raporteve nga komisionet e formuara për shqyrtim.

## **NENI 35**

### **KRYETARI I DEGËS**

1. Kryetari është personaliteti më i lartë i Degës së KKK.
2. Kryetari është përgjegjës para Kuvendit të Degës, për të siguruar se Dega ushtron detyrat, objektivat e përcaktuara me Statut dhe aktet tjera normative.
3. Kryetari vepron nën autoritetin e Kuvendit dhe Kryesisë, për drejtimin e Degës së KKK, në përputhje me vendimet që janë marrë në nivel qendror.
4. Pozita e kryetarit të degës është vullnetare (pa pagesë).
5. Funkcionet e Kryetarit të degës janë:
  - 5.1. Të thërret dhe të kryesojë seancën e Kuvendit të punës dhe mbledhjen e Kryesisë së Degës;
  - 5.2. T'i paraqet Kuvendit dhe Kryesisë një pasqyrë të gjendjes së përgjithshme të KKK të Degës;

- 5.3. Të mbikëqyrë realizimin e veprimtarisë të degës së KKK në përputhshmëri me Parimet Themelore të Lëvizjes, politikat, rregulloret, vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e miratuara në nivel qendror;
- 5.4. Të përfaqësojë Kryqin e Kuq të Degës në nivel të saj;
- 5.5. Kryetari në rast nevojë mund t'ia bartë një pjesë të kompetencave dhe përgjegjësive të zëvendëskryetari.
6. Zëvendëskryetari i Degës:
  - 6.1. Në rast të mungesës së Kryetarit ose në rast se Kryetari nuk është në gjendje të kryejë këtë funksion, funksionin e kryen zëvendëskryetari deri në seancën e ardhshme të Kuvendit
  - 6.2. Pozita e zëvendëskryetarit të degës është vullnetare (pa pagesë).

## **NENI 36**

### **KOMISIONI FINANCIAR I DEGËS**

1. Komisioni financiar zgjedhet nga Kuvendi i Degës dhe ka mandat 4 vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat (dy mandate të njëpasnjëshme).
2. Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe dy anëtar ekspert të fushës përkatëse.
3. Anëtarët e komisionit financiar duhet të jenë anëtar të Kryqit të Kuq të Kosovës por jo delegat të Kuvendit të Degës.
4. Detyra e komisionit financiar është të përkrah në hartimin e buxhetin, mbikëqyrë veprimtarinë materiale-financiare të Degës, hartoj raportet financiare periodike dhe vjetore.
5. Komisioni financiar i degës i raporton Kryesisë së Degës, Kuvendit të Degës dhe Komisionit Financiar Qendror.

## **NENI 37**

### **SEKRETARI I DEGËS**

1. Sekretari i degës propozohet nga Kryesia e Degës.
2. Sekretari i degës emërohet nga Kryesia Qendrore.
3. Sekretari i degës shkarkohet me vendim të Kryesisë Qendrore të KKK.
4. Sekretari i degës është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Degës, Kryesisë së Degës dhe Sekretarit të Përgjithshëm.
5. Sekretari i Degës është përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e programeve, projekteve, aktiviteteve në territorin e degës sipas politikave, rregulloreve dhe vendimeve të nivelit qendror.
6. Bashkëpunon me organet e pushtetit në nivel lokal, akterë të tjerë dhe OJQ të tjera për çështje të lidhura me veprimtarinë humanitare të KKK në koordinim me Zyrën Kryesore.
7. Është përgjegjës për administratën, financa dhe pasurinë e degës.

8. Informon dhe raporton me shkrim rregullisht Zyrën Kryesore dhe Sekretarin e Përgjithshëm për aktivitetet në degë.
9. Merr pjesë në pranimin e të punësuarve të degës, për qëllim të transparencës
10. Propozon planin vjetor të punës dhe financiar dhe raporton për gjendjen financiare, në bashkëpunim me komisionin financiar të degës.
11. Raporton për punën e bërë në degë dhe planin e punës, për Kryesi të degës , Kuvend të degës dhe Zyre Kryesore.
12. Sekretari i degës është i obliguar që të mbajë të informuar Kryetarin e Degës.
13. Sekretari i Degës nuk është anëtar i Kryesisë së Degës.
14. Sekretari i Degës duhet të përgatitë dhe të marrë pjesë në seancat e Kuvendit dhe Kryesisë së Degës.
15. Ndhmon punën e seancave pa të drejtë vote.
16. Mandati i Sekretarit të Degës është 4 vjeçar me mundësi të riemërimit.

## KAPITULLI VI:

### PAJTUESHMËRIA, INTEGRITETI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

#### NENI 38

1. Kryesia Qendrore e Shoqatës Kombëtare të KKK siguron që të gjitha nivelet e Shoqatës të respektojnë integritetin dhe standardet etike, si:
  - 1.1. Respektimin e Parimeve Themelore të Lëvizjes, politikat dhe rregulloret e Shoqatës Kombëtare;
  - 1.2. Mbrojtjen e konfidencialitetit, ruajtjen e besimit të atyre që i shërben Shoqata Kombëtare;
  - 1.3. Veprimin dhe marrjen e vendimeve në interes të Shoqatës Kombëtare kur vepron në emër të saj;
  - 1.4. Trajtimin e të gjithëve me dinjitet, respekt dhe heqja dorë nga:
    - 1.4.1. Diskriminimi në bazë të gjinisë, origjinës etnike, kombësisë ose shtetësisë, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, besimit fetar, prejardhjes sociale ose ndonjë arsye tjetër të ngjashme,
    - 1.4.2. Ksenofobia dhe forma tjera të racizmit,
    - 1.4.3. Ngacmimi në përgjithësi dhe ngacmimi seksual,
    - 1.4.4. Shfrytëzimi seksual dhe abuzimi.
  - 1.5. Veprimi me ndershmëri dhe me integritet në të gjitha transaksionet dhe marrëdhëniet, që përfshijnë heqjen dorë nga mashtrimi dhe korrupsioni, shpërdorimi i pushtetit dhe nepotizmi;
  - 1.6. Shmangja e konfliktit të interesit dhe trajtimi në mënyrë të përshtatshme, konfliktet e interesave aktuale ose të mundshme.
2. Kryesia Qendrore e Shoqatës Kombëtare të KKK siguron që politikat përkatëse dhe Kodi i Mirësjelljes për individët në pozita qeverisëse, stafin dhe vullnetarët, të respektohen me qëllim të ruajtjes së integritetit dhe standardeve të cekura më lart, duke mos u hakmarrë kundër dhe të mbrojnë konfidencialitetin e kujt do që bën ankesë në besim të plotë.
3. Kryqi i Kuq i Kosovës përmes Rregulloreve përkatëse, përcakton klasifikimin e shkeljeve të detyrave të punës, procedurave disiplinore dhe masave që shqiptohen.
4. Kryqi i Kuq i Kosovës përmes Rregullores për Procedura Disiplinore dhe Rregullores së Procedurave për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, përcakton procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave nga marrëdhëniet e punës së të punësuarve, për individët në pozita qeverisëse, vullnetarët dhe kriteret për emërimin e anëtarëve të komisioneve përkatëse.

## **KAPITULLI VII:**

### **ÇËSHTJET FINANCIARE**

#### **NENI 39**

1. Kryqi i Kuq i Kosovës posedon pasuri jofinanciare në pronësi të përhershme. Me këtë pasuri udhëheq Kryesia Qendrore respektivisht Kuvendi i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq të Kosovës.
2. Përgjegjësin për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë jofinanciare të KKK është e Sekretarit të Përgjithshëm dhe administratës së KKK
3. Përgjegjësia për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë jo financiare së Degës së KKK është Sekretari i Degës
4. Për tjetërsimin e pasurisë jo financiare në nivel lokal dhe qendror, kompetent është Kryesia Qendrore dhe Kuvendi i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq të Kosovës.

#### **NENI 40**

#### **FINANCAT**

1. Kryqi i Kuq i Kosovës, për të përmbushur mandatin e vet humanitar, mund të realizoj të hyra financiare nga:
  - 1.1. Anëtarësia,
  - 1.2. Trashëgimia dhe donacionet,
  - 1.3. Nga projekte të ndryshme,
  - 1.4. Nga lotaria dhe lojërat e fatit,
  - 1.5. Të hyrat me Marrëveshje të Bashkëpunimit me Ministrinë përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
  - 1.6. Nga aksionet tradicionale,
  - 1.7. Nga Organizatat Ndërkombëtare dhe Shoqatat Nacionale simotra,
  - 1.8. Nga planifikimet buxhetore sipas Ligjit të KKK,
  - 1.9. Të tjera.
2. Kryqi i Kuq i Kosovës mund të kontaktojë organizata shërbyese si dhe të kontrakttojë punë shërbyese konform Ligjit për veprimtarinë e Kryqit të Kuq të Kosovës.
3. KKK nuk pranon donacione që burojnë drejtpërdrejtë nga të ardhurat e veprimtarive që bien ndesh me Parimet Themelore të Lëvizjes.

## NENI 41

1. Kryesia e KKK dhe Zyra Qendrore menaxhon pasurinë financiare dhe jo financiare, dhe obligohet të raportojnë për çdo dy vite kalendarike në bashkëpunim me komisionin për financa para Kuvendit të Kryqit të Kuq të Kosovës.
2. Kryqi i Kuq i Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe me Standardet Ndërkombëtare të raportimit financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Ligji 04/L-57 “Për Lirinë e Asociimit në Organizatat jo Qeveritare”.
3. Kryesia Qendrore e KKK fuqizon dhe përkrah mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të kontrollit të jashtëm.
4. KKK angazhon auditorin e pavarur për auditim sipas legjislacionit në fuqi.
5. KKK respekton procedurat e prokurimit konform legjislacionit në fuqi.

## **KAPITULLI VIII:**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **NENI 42**

1. Statuti i Kryqit të Kuq të Kosovës miratohet nga Kuvendi i Kryqit të Kuq të Kosovës me shumicën 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve të pranishëm në Kuvend me të drejtë vote.
2. Propozimin dhe hartimin e Statutit e përcakton Kryesia Qendrore e Kryqit të Kuq të Kosovës.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e dispozitave të Statutit kryhen në mënyrën dhe procedurën si për miratimin e tij.
4. Për miratimin e Statutit të ri, si dhe për ndryshimin dhe plotësimin e tij, nevojitet rishikim dhe pëlqim paraprak i Komisionit të përbashkët të Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe Komitetit Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq për Statutet e shoqatave nacionale, dhe në përputhje me Konferencën e 22-të Ndërkombëtare e mbajtur në Teheran në vitin 1973 dhe Rezoluta e 6 e saj.

#### **NENI 43**

#### **SHPËRBËRJA**

1. Kryqi i Kuq i Kosovës ndërpret punën kur Kuvendi i Përgjithshëm merr vendim për ndërprerjen e punës së Kryqit të Kuq të Kosovës si Shoqatë në tërësi, me shumicën 2/3 (dy të tretat) e numrit të përgjithshëm të delegatëve të Kuvendit të Përgjithshëm me të drejtë vote dhe shumicë të kualifikuar.
2. Ndërprerja e punës së Kryqit të Kuq të Kosovës, çështja e pasurisë dhe detyrimet, zgjidhen në përputhje me këtë Statut, dispozitat ligjore dhe rregulloret ekzistuese.
3. Ndërprerja e punës së KKK, nëse Kuvendi i Përgjithshëm nuk merr vendim tjetër, atëherë tërë pasuria e KKK i kalon Republikës së Kosovës.
4. Pjesa tjetër e mjeteve financiare jepen vetëm për qëllime humanitare të dedikuara për të mirën e përgjithshme.
5. Materialet arkivore të Kryqit të Kuq të Kosovës për shkak të rëndësisë së tyre në tërësi do t'i dorëzohen Arkivit të Republikës së Kosovës.

#### **NENI 44**

Aktet që dalin nga ky Statut harmonizohen dhe miratohen, më së voni në afat prej 6 (gjashtë) muajsh nga dita e miratimit të tij.

## **NENI 45**

Miratimi i këtij statuti shfuqizon Statutin e Kryqit të Kuq të Republikës së Kosovës të datës 13 Mars 2005 dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij të datës 01 Dhjetor 2011.

## **NENI 46**

Statuti hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Miratuar nga delegatët në Kuvendin e Punës të Kryqit të Kuq të Kosovës, mbajtur në Prishtinë, më 23 Nëntor 2019.

Kryetari,